



SHOQATA  
PER AUTONOMI  
VENDORE



SHOQATA E  
BASHKIVE TË  
SHQIPËRISË




# #Renta4 Bashkitë R4B



Funded by  
the European Union

# Propozime ligjore mbi mundësinë e rritjes së përqindjes së rentës në favor të bashkive

Shoqata për Autonomi Vendore dhe Shoqata e Bashkive të Shqipërisë kanë bashkuar përpjekjet e tyre lobuese për të sjellë një ndryshim të përqindjes së rentës në favor të bashkive dhe në funksion të rritjes së standardit të shërbimeve qytetare. Një nisëm që vjen në kuadër të projektit 'Dialog për zhvillim politikash gjithëpërfshirëse në Shqipëri (ideAL)' implementuar nga Co-PLAN Instituti për Habitat dhe Zhvillim në bashkëpunim me Qendrën Evropiane të Politikave (Bruksel) dhe me mbështetjen financiare të Delegacionit të Bashkimit Evropian në Shqipëri.



**Për më shumë  
demokraci vendore  
dhe autonomi  
financiare**

# PËRMBLEDHJE

Proçeset reformuese të ndërmarra vitet e fundit për pushtetin vendor kanë sjellë ndikimin e tyre pozitiv në buxhetin e bashkive, veçanërisht me Ligjin 68/2017 të financave vendore. E megjithatë dhe ky ligj nuk solli përfitime të rritura për bashki me pasuri të mëdha nëntokësore në territorin e tyre.

25% e bashkive<sup>1</sup> zotërojnë në territorin e tyre pasuri të mëdha natyrore dhe ku operojnë 40 - 48% e licensave aktive. Këto bashki sipas të dhënave të Instat për 2018 renditen të bashkitë me nivel të lartë varfërie, pavarësisht pasurive natyrore të tyre. Këto bashki kanë adresuar vazhdimisht tek Shoqatat, kërkesa për të rritur nivelin e rentës për bashkitë mbi 5%, si dhe thjeshtimin e mekanizmave deri tani burokratike të cilat kanë çuar në mospërthithjen as të 5% të garantuar nga ligji.

Shoqata për Autonomi Vendore dhe Shoqata e Bashkive të Shqipërisë bashkuan përpjekjet e tyre lobuese për të sjellë një ndryshim të përqindjes së rentës në favor të bashkive dhe në funksion të rritjes së standartit të shërbimeve qytetare. Një projekt që vjen në kuadër të projektit 'Dialog për zhvillim politikash gjithëpërfshirëse në Shqipëri (ideAL)' implementuar nga Co-PLAN Institute for Habitat Development në bashkëpunim me European Policy Center (Bruksel) dhe me mbështetjen financiare të European Union in Albania.

ShAV dhe ShBSh janë të vetmet organizata që përfaqësojnë nivelin e parë të qeverisjes vendore në nivel të përfaqësimit politik dhe teknik. Të dyja organizatat kanë vite eksperience pune me bashkitë dhe ofrimin të asistencës ndaj tyre. Shoqatat kanë përfaqësuar dhe lobuar për bashkitë në shumë çështje që lidhen me decentralizimin, transferimin e funksioneve të reja dhe në përmirësimin e financave vendore. Përfaqësimi i shoqatave qëndron si në nivelin politikbërjes vendore, pra këshillat bashkiakë, ashtu dhe për nivelin ekzekutiv, pra kryetarin dhe administratën. Puna jonë me bashkitë shtrihet edhe nëpërmjet ngritjes dhe funksionimit të shumë forumeve profesionale të përhershme dhe të përkohshme, të cilat diskutojnë dhe formulojnë qëndrime dhe rekomandime për rritjen e autonomisë vendore.

---

1 Bulqiza, Patosi, Klosi, Mirëdita, Kukësi, Roskoveci, Selenica, Ura Vajgurore, Skrapari, Vlora, Fushë-Arrëzi, Mati, Berati dhe Mallakastër

# QËLLIMI I PROJEKTIT

*Reforma territoriale nëpërmjet Ligjit organik 139/2015, Ligjit 68/2017 për financat vendore i dha mundësi të reja bashkive si në rritjen e autonomisë vendore ashtu dhe në përmirësimin e financave të bashkive.*

*Një nga instrumentet e përmirësimit të financave vendore janë dhe taksat e ndara, ku një prej tyre është dhe renta minerare, niveli i ndarjes së të cilës nuk ka ndryshuar me ndërhyrjet e fundit ligjore. Niveli i saj sot është vetëm 5% në favor të bashkive, krahasuar me vendet e rajonit në një përqindje shumë të ulët.*

*Kërkesa për rishikimin dhe rritjen e nivelit të përfitimit për pushtetin vendor të rentës minerare vjen nga bashkitë.*

*ShAV dhe ShBSh së bashku udhëhoqën një proces konsultimi dhe takimesh në terren me 30 bashkitë ku renta ka potencial të konsiderueshëm për rritjen e ekonomive vendore pa dëmtuar interesat kombëtare. Nëpërmjet zbatimit të projektit, ne rritëm kapacitetet vlerësuese të bashkive, njohuritë e tyre mbi mënyrën dhe ndjekjen e procedurave për marrjen e rentës, njohjen e kuadrit ligjor etj. ShAV dhe ShBSh punoi ngushtësisht me të gjithë aktorët teknikë duke lobuar me aktorët politikë (ministritë e linjave) që të arrijmë objektin për ndryshime ligjore për rritjen e nivelit të rentës drejt bashkive në disa opsione duke nisur nga 25% si opsioni më i arritshëm, në Opsionin e dytë për 25-35% e rentës në favor të bashkive dhe opsioni tretë është ndarja 50%-50% mes qeverisë dhe bashkive.*

## **Objektivat e Përgjithshme e projektit është të kontribuojë në:**

- *forcimin e autonomisë fiskale dhe financiare të NJQV-ve si element i rëndësishëm i decentralizmit dhe forcimit të demokracisë vendore duke dialoguar me aktoret publike për rritjen e niveit të rentes nga 5% në të pakten 10%.*

## **Si dhe Objektivat Specifikë me synim në:**

- *Rritjen e kapaciteve bashkiake për të vlerësuar potencialin real të të ardhurave nga renta minerare;*
- *Ndërgjegjësimin e aktorëve në nivel kombëtar përfshirë Këshillin Konsultativ, ministritë e linjës Komisionin parlamentar për Ekonominë dhe Financat si dhe Nënkomisionin parlamentar për Qeverisjen Vendore.*
- *ndryshime ligjore për rritjen e nivelit të rentës drejt bashkive në varësi të opsionit të pranuar*

Ky propozim i ndërmarrë nga Shoqatat e Autoriteteve Lokale parashikon një qasje strategjike shumëvjeçare për t'iu përgjigjur nevojave të njësisve të vetëqeverisjes vendore (NJQV), ndër të tjera, ky propozimin angazhohet në forcimin e kapaciteteve vendore, zgjerimin e autonomisë financiare bazuar në shtimin e burimeve të drejtpërdrejta vendore dhe rritjen e shërbimeve publike. Këto nevoja do të trajtohen nëpërmjet shkëmbimit të njohurive dhe vlerësimit real të kapaciteteve mbi burimet financiare vendore dhe përvojave ndërmjet bashkive mbi procesin, procedurat dhe politikat mbi rentën.

Popullsia e NJQV-të të përzgjedhura është gjithsej 387,779 banorë, që përfaqësojnë afërsisht 17% të popullsisë në nivel kombëtar. Këto NJQV, janë të shtrira në afërsisht 7152 km<sup>2</sup>, çka përfaqëson, gjithashtu, 25% të sipërfaqes së përgjithshme të territorit të vendit. Ato kanë në përbërjen e tyre një numër të përgjithshëm prej gati 105 njësisish administrative. Numri i licensave minerare në këto bashki zë 42% (259) të numrit të përgjithshëm (622) të liçensave aktive në të gjithë territorin e vendit. Në studimin e realizuar për mbledhjen, transferimin dhe përdorimin e rentës vlerësohet se këto NJQV përfitojnë 90% të rentës së shpërndarë në të gjithë vendin.

Sa më sipër këto të dhëna dhe fakte tregojnë rëndësinë që ka kjo çështje, por nga ana tjetër sesa i rëndësishëm është fakti se realisht bashkitë nuk përfitojnë nivelin e rentës aktuale të caktuar në ligj, si dhe burokracitë administrative që duhen reduktuar dhe thjeshtëzuar. Eleminimi I këtyre burokracive, bërja transparente e të dhënave nga palët publike dhe private do të kontribuojë shumë në eliminimin e përplasjeve bashki – ente private dhe drejtori të taksave dhe doganave. Fakti që sot as kjo përqindje (5%) nuk shkonë në bashki e bën emergjente ndërhyrjen, krahas nivelit të ulët ekzistues.

Nisma e ShAV dhe ShBSh është propozimi për përmirësimin e shpërndarjes së taksës së rentës duke ndërhyrë në rrjedhën aktuale të procesit të shpërndarjes dhe bazës ligjore që rregullon këtë fushë, i cili synon të ofrojë një vështrim të përgjithshëm për industrinë nxjerrëse, ndikimin e saj social-ekonomik dhe mjedisor, si dhe shpërndarjen e rentës minerare. Propozimi synon përmirësimin e lidhjes midis burimeve natyrore dhe pjesës që u takon atyre që i zotërojnë këto burime dhe organeve të pushtetit vendor.

#### *Dokumenti është i ndarë në tre seksione kryesore:*

1. Pjesa e parë bën një analizë të ndikimit shoqëror, ekonomik dhe mjedisor të industrisë nxjerrëse si dhe një përmbledhje të kuadrit ligjor dhe rregullator të procesit të shpërndarjes së rentës.
2. Pjesa e dytë e dokumentit paraqet procesin e tanishëm të shpërndarjes së rentës, së bashku me institucionet e përfshira dhe hapat që kryhen, si

dhe parashtrohet një propozim për ndryshimin e rrjedhës së këtij procesi me synim rritjen e efikasitetit.

3. Pjesa e tretë e dokumentit ka si qëllim analizimin e sasisë të të ardhurave nga renta në buxhetin e vendit dhe në buxhetin e pushtetit vendor, si dhe të paraqesë një propozim për ndryshimin e raportit të shpërndarjes me synim rritjen e burimeve të drejtpërdrejta për NJQV-të.

Trajtimi i çështjes së rentës në favor të pushtetit vendor, është në harmoni me politikën e BE-së për reformimin e administratës dhe forcimin e saj në nivel qendror dhe vendor, sikundër edhe rritjen e autonomisë financiare dhe konsolidimin e institucioneve të pavarura kushtetuese siç janë bashkitë. Ky propozim është real për të ndihmuar bashkitë në përthithjen e plotë të tyre dhe në përfitimin e resurseve të reja financiare bazuar në ligjin dhe dokumenta strategjike ku rritja e të ardhurave të drejtpërdrejta ka ndikim të konsiderueshëm në autonominë financiare të NJQV-ve. Kjo do të sjellë gjithashtu një përmirësim të autonomisë fiskale si një element i rëndësishëm për decentralizimin në funksion të forcimit të demokracisë.

# RELACION

## PËR PROJEKTLIGJIN

### **“PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR. 68/2017, “PËR FINANCAT E VETËQEVERISJES VENDORE”**

#### **I. QËLLIMI I PROJEKTLIGJIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN**

Propozimi i projektligjit “Për një ndryshim në ligjin nr. 68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore” është mbështetur në nenet 78, dhe 83, pika 1 të Kushtetutës.

Qëllimi i përgatitjes së këtij projektligji synon ndryshime lidhur me rritjen e decentralizimit fiskal të pushtetit vendor me transferimin e më shumë të ardhurave dhe në mënyrë më eficiente nga renta minerare. Një ndarje e drejtë dhe më efikase e të ardhurave midis qeverisë qendrore dhe njësive të vetëqeverisjes vendore do t'i ofronte këtyre të fundit burime më të drejtpërdrejta, jo vetëm për të kompensuar pasojat direkte dhe indirekte që sjellin ndërmarrjet nxjerrëse dhe përpunuese për banorët dhe fermerët në këto zona, por edhe për të siguruar investime të dedikuara për përmirësimin e mjedisit të përgjithshëm social dhe ekonomik në këto NJQV.

#### **II. VLERËSIM I PROJEKTLIGJIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTAVE TË TJERA.**

Projektligji nuk është përfshirë në programin analitik të akteve, por është në përputhje me objektivat e qeverisë shqiptare për të vazhduar mbështetjen e njësive të vetëqeverisjes vendore për arritjen me efektivitet të objektivave strategjike të reformave decentralizuese të ndërmarra, të cilat synojnë fuqizimin e qeverisjes vendore, rritjen e efikasitetit të administratës publike dhe përmirësimin e ofrimit të shërbimeve për qytetarët.

#### **III. ARGUMENTIMI I PROJEKTLIGJIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME.**

Ky projektligj synon të rregullojë raportet e nevojshme të shpërndarjes së rentës minerare në mënyrë të drejtë duke ndikuar në fuqizimin e njësive të vetëqeverisjes vendore (NJQV-ve) pasi kjo ndihmon në autonominë e tyre financiare. Problematikat që kanë ardhur si pasojë e zbatimit në praktikë



të ligjit kanë evidentuar se niveli aktual prej 5% i shumës së rentës që i transferohet NJQV-ve është i vogël dhe nuk vendos një raport të drejtë me banorët e këtyre zonave, të cilët paguajnë kostot e drejtpërdrejta dhe të tërthorta të industrive nxjerrëse. Zgjedhur me votim të drejtpërdrejtë, NJQV-të marrin përsipër të plotësojnë më mirë nevojat parësore të qytetarëve përmes rritjes së shërbimeve të drejtpërdrejta për ta dhe gjenerimit të burimeve të nevojshme për shërbime, bazuar në një vizion specifik, strategji përkatëse, buxhete, programe dhe projekte konkrete. Bazuar tek përvoja ndërkombëtare, renta duhet të financojë gjithashtu investimet në bashkitë ku këto kompani nuk veprojnë drejtpërdrejt, por shkaktojnë dëme kolaterale. Përvojat ndërkombëtare marrin parasysh kryesisht numrin e popullsisë së njësisë dhe madhësinë e zonës. Në përgjithësi, kjo ndarje varion nga 65-70 përqind sipas numrit të popullsisë, dhe 30-35 përqind sipas sipërfaqes territoriale të njësisë administrative. Ky raport nënvizon thelbin e përdorimit të të ardhurave nga renta, kryesisht për të zvogëluar dhe zbutur kostot direkte dhe indirekte me të cilat përballet popullsia që jeton në njësitë administrative që preken nga veprimtaria e ndërmarrjeve private. Megjithatë në kontekstin shqiptar me qëllim edhe ruajtjen e ekuilibrave buxhetorë një ndarje më e barabartë por gjithsesi më në favor të pushtetit qendror sjell një kontribut më cilësor nga të dy llojet e pushteteve tek qytetari.

Ndikimi i aktivitetit të industrisë minerare dhe industrive të tjera nxjerrëse për të cilat paguhet renta minerare është dhe mbetet drejtpërdrejt në popullsinë e zonave ku zhvillohet aktiviteti. Ndikimi në aspektin shoqëror dhe mjedisor, ka bërë që pasojat të jenë shpeshherë të vështira për t'u recuperuar dhe gjithsesi autoritetet që janë më shumë në kontakt me zonat dhe komunitetet janë NJQV-të. Për shembull, tokat bujqësore apo ekosistemet përreth disa zonave kanë nevojë për ndërhyrje dhe financim për t'ia rikthyer komuniteteve. Qytetarët që banojnë në këto zona duhet të prekin dhe përjetojnë rezultate në përmirësimin e jetës së tyre nga përdorimi i këtyre burimeve. Ky është një nga elementët kryesorë jo vetëm në zhvillimin afatgjatë të këtyre zonave, por edhe në krijimin e urave bashkëpunuese midis bizneseve të kësaj industrie dhe komuniteteve.

Ndryshimi i raportit të shpërndarjes së të ardhurave nga renta nga 5 në 25% në për kategoritë e rentës minerare, do të ulte sasinë e të ardhurave që shkojnë në buxhetin e shtetit, por do të kishte një ndikim minimal në qëndrueshmërinë e financave publike. Ndryshimi ligjor në fjalë rregullon rritjen e shpërndarjes së rentës nga industria minerare në 20% dhe po 25% për rentën minerare të paguar nga subjektet që ushtrojnë veprimtarinë në sektorin e hidrokarbureve sipas rregullimit të posaçëm të bërë në ligjin për taksat kombëtare. Në anën tjetër, rritja e të ardhurave të drejtpërdrejta ka ndikim të konsiderueshëm në autonominë financiare të NJQV-ve dhe këto

të ardhura do të rrisin burimet financuese për pasojat e drejtpërdrejta dhe të tërthorta të veprimtarive të ndërmarrjeve nxjerrëse. Kjo do të sjellë gjithashtu një përmirësim të autonomisë fiskale dhe financiare të NJQV-ve, si një element i rëndësishëm për decentralizimin në funksion të forcimit të demokracisë. Rishikimi i raporteve të shpërndarjes së të ardhurave nga burimet natyrore midis qeverisë qendrore dhe NJQV-ve është proces dinamik, i cili sjell rritjen e pjesës që u takon drejtpërdrejtë NJQV-ve duke i kthyer këto të ardhura në investime për komunitetet. Një ndarje e drejtë dhe më efikase e të ardhurave midis qeverisë qendrore dhe NJQV-ve do t'i ofronte këtyre të fundit burime më të drejtpërdrejta, jo vetëm për të kompensuar pasojat direkte dhe indirekte që sjellin ndërmarrjet nxjerrëse dhe përpunuese për banorët dhe fermerët në këto zona, por edhe për të siguruar investime të dedikuara për përmirësimin e mjedisit të përgjithshëm social dhe ekonomik në këto NJQV.

#### **IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUESHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR**

Projektligji është mbështetur në nenet 78 dhe 83, pika 1 të Kushtetutës. Miratimi i këtij projektligji është në përputhje me legjislacion kombëtar dhe ndërkombëtar.

#### **V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTARE**

Ky projektligj nuk synon përafrimin e legjislacionit me acquis communautaire.

#### **VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTLIGJIT**

Nga pikëpamja teknike, projektligji është hartuar në 2 nene.

- Në nenin 1, të projektligjit, propozohet që përqindja e të ardhurave nga renta minerare i takojnë pushtetit vendor ku zhvillohet veprimtaria të jetë 25 për qind me rregullimit e posaçëm që rregullohet në ligjin për taksat kombëtare.
- Në nenin 2 të projektligjit, parashikohet hyrja në fuqi e tij.

#### **VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN ME ZBATIMIN E AKTIT**

Organet dhe subjektet përgjegjëse për zbatimin e këtij projektligji janë Këshilli i Ministrave, Ministria e Financave, dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore.

## **VIII. MINISTRITË INSTITUCIONET DHE PERSONAT QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKT-AKTIT**

Projektligji është hartuar nga grupi i punës së ngritur nga prezenca e OSBE në Shqipëri me ekspertët e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe i konsultuar me përfaqësitë e njësive të vetëqeverisjes vendore.

## **IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE**

Projektligji parashikon efekte financiare në buxhetin e shtetit nga propozimi për ndryshimin e raportit të shpërndarjes si dhe ka një ndikim minimal në qëndrueshmërinë e financave publike. Projektligji shoqërohet me një rritje të të ardhurave vendore prej si pjesë e mbështetjes për reformat madhore të decentralizimit të iniciuara nga qeveria.

Analiza e produktit të brendshëm bruto/PBB dhe të ardhurat totale të buxhetit për periudhën 2015-2022 tregon se të ardhurat totale nga renta i përqindje e PBB-së, të ardhurat totale nga renta janë vetëm 0.25% ndërsa të ardhurat totale të buxhetit të shtetit janë 0.89 për qind. Bazuar në këta tregues, pesha shumë e vogël e të ardhurave nga renta në burimet totale të buxhetit të shtetit krijon hapësira për studimin e opsioneve për të rritur gradualisht pjesën e NJQV-ve nga 5 për qind që është tashmë në një pjesë përqindjeje më të drejtë dhe më mbështetëse, të paktën në sektorin minerar që është ai që sjell dhe dëmtimet më të mëdha, e cila mund të sjellë përfitime reale për komunitetin në këto fusha pa cenuar stabilitetin e financave publike dhe rregullat e menaxhimit të financave publike.

Më konkretisht, propozimi për ndryshimin e masës përfituese që i kalon pushtetit vendor nga 5% që është aktualisht në 25%, ka këto ndikime financiare në buxhet bazuar mbi të dhënat buxhetore të viteve 2018-2020. Rezulton se për vitin 2020, pushteti vendor mund të përfitonte rentë minerare në vlerën 561 milionë lekë, pra 449 milionë lekë më shumë sesa ka përfituar realisht gjatë këtij viti.

Për vitin 2019, pushtetit vendor mund ti takonte vlera 909 milion lekë ose ndryshe rreth 727 milion lekë më shumë se sa ka përfituar. Ndërsa për vitin 2018, ky parashikim përcakton si masë takuese vlerën rreth 934 milion lekë ose ndryshe rreth 747 milion lekë më shumë se masa që ka përfituar. Raportet e vlerës së rentës minerare që i kalon pushtetit vendor (parashikimi 25%), krahasuar me të ardhurat e pushtetit qendror, transfertën e pakushtëzuar, apo shpenzimet e pushtetit vendor paraqiten si më poshtë:

- Të ardhurat nga renta minerare akorduara nga pushteti qendror njësive të vetëqeverisjes vendore (parashikimi 25%), në raport me shpenzimet e pushtetit vendor për vitin 2020, parashikohet të zërë rreth 0.14%, për vitin 2019 pesha do të ishte rreth 0.21%, ndërsa për vitin 2018 rreth 0.22%. Për të tre vitet përqindja do të ishte më e lartë se ajo që është aktualisht;
- Të ardhurat nga renta minerare akorduara nga pushteti qendror njësive të vetëqeverisjes vendore (parashikimi 25%), në raport me transfertën e pakushtëzuar që i transferohet pushtetit vendor nga ai qendror për vitin 2020, zënë rreth 2%, për vitin 2019 zënë rreth 4%, si dhe për vitin 2018 zënë po rreth 4%;
- Të ardhurat nga renta minerare akorduara nga pushteti qendror njësive të vetëqeverisjes vendore (parashikimi 25%), në raport me shpenzimet e pushtetit vendor për vitin 2020 zënë rreth 1.1%, për vitin 2019 rreth 1.6%, si dhe për vitin 2018 rreth 1.9%.

Siç shihet, ndikimi i uljes së të ardhurave nga renta minerare për buxhetin e shtetit është shumë i ulët, ndërsa rritja e pjesës për pushtetin vendor zë një peshë të konsiderueshme për buxhetin vendor.

## **KËSHILLI I MINISTRAVE**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI**

**PROJEKTLIGJ**

**Nr. \_\_\_\_ / 2021**

**PËR**

**NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR. 68/2017, "PËR FINANCAT E  
VETËQEVERISJES VENDORE"**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e një deputeti,

**KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**V E N D O S I:**

Në ligjin në ligjin nr. 68/2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore", bëhet ky ndryshim:

**Neni 1**

Në nenin 25, gërma c) e pikës 2 ndryshohet si më poshtë:

"25 për qind e të ardhurave nga renta minerare, sipas përcaktimeve të bëra në ligjin për taksat kombëtare".

**Neni 2**

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**K R Y E T A R I**

# RELACION

## PËR PROJEKTLIGJIN

### **“PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.9975, DATË 28.7.2008, “PËR TAKSAT KOMBËTARE’, TË NDRYSHUAR”**

#### **X. QËLLIMI I PROJEKTLIGJIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN**

Propozimi i projektligjit “Për një ndryshim në ligjin nr.9975, datë 28.7.2008 ‘Për taksat kombëtare’, të ndryshuar është mbështetur në nenet 78, 83, pika 1, dhe 155, të Kushtetutës. Ky projektligj është pjesë e paketës fiskale 2022.

Qëllimi i përgatitjes së këtij projektligji synon ndryshime lidhur me rritjen e decentralizimit fiskal të pushtetit vendor me transferimin e më shumë të ardhurave dhe në mënyrë më efiçente nga renta minerare. Shpërndarja e rentës në mënyrë të drejtë dhe të shpejtë luan rol të rëndësishëm në forcimin e autonomisë financiare të njësive të vetëqeverisjes vendore dhe mund t’u japë komuniteteve lokale më shumë kompetenca në vendim-marrje. Një ndarje e drejtë dhe më efikase e të ardhurave midis qeverisë qendrore dhe njësive të vetëqeverisjes vendore do t’i ofronte këtyre të fundit burime më të drejtpërdrejta, jo vetëm për të kompensuar pasojat direkte dhe indirekte që sjellin ndërmarrjet nxjerrëse dhe përpunuese për banorët dhe fermerët në këto zona, por edhe për të siguruar investime të dedikuara për përmirësimin e mjedisit të përgjithshëm social dhe ekonomik në këto NJQV.

#### **XI. VLERËSIM I PROJEKTLIGJIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTAVE TË TJERA.**

Projektligji nuk është përfshirë në programin analitik të akteve, por është në përputhje me objektivat e qeverisë shqiptare, për garantimin e decentralizimit të plotë organik dhe ekonomik të njësive të vetëqeverisjes vendore.

#### **XII. ARGUMENTIMI I PROJEKTLIGJIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME.**

Ky projektligj synon të rregullojë raportet e nevojshme të shpërndarjes së rentës minerare në mënyrë të drejtë dhe të shpejtë e cila luan rol në fuqizimin e njësive të vetëqeverisjes vendore (NJQV-ve) pasi ndikon në autonominë e tyre financiare. Problematikat që kanë ardhur si pasojë e zbatimit në praktikë të ligjit kanë evidentuar se niveli aktual prej 5% i shumës së rentës që i

transferohet NJQV-ve nga industria minerare është i vogël dhe nuk vendos një raport të drejtë me banorët e këtyre zonave, të cilët paguajnë kostot e drejtpërdrejta dhe të tërthorta të industrive nxjerrëse. Zgjedhur me votim të drejtpërdrejtë, NJQV-të marrin përsipër të plotësojnë më mirë nevojat parësore të qytetarëve përmes rritjes së shërbimeve të drejtpërdrejta për ta dhe gjenerimit të burimeve të nevojshme për shërbime, bazuar në një vizion specifik, strategji përkatëse, buxhete, programe dhe projekte konkrete. Bazuar tek përvoja ndërkombëtare, renta duhet të financojë gjithashtu investimet në bashkitë ku këto kompani nuk veprojnë drejtpërdrejt, por shkaktojnë dëme kolaterale. Për shembull, kjo mund të përfshijë dëme të infrastrukturës siç janë rrugët, vaditja, kullimi, etj., apo bujqësisë, si përkeqësimi i cilësisë së tokës dhe rrjedhimisht cilësisë së prodhimeve bujqësore. Përvojat ndërkombëtare marrin parasysh kryesisht numrin e popullsisë së njësisë dhe madhësinë e zonës. Në përgjithësi, kjo ndarje varion nga 65-70 përqind sipas numrit të popullsisë, dhe 30-35 përqind sipas sipërfaqes territoriale të njësisë administrative. Ky raport nënvizon thelbin e përdorimit të të ardhurave nga renta, kryesisht për të zvogëluar dhe zbutur kostot direkte dhe indirekte me të cilat përballet popullsia që jeton në njësitë administrative që preken nga veprimtaria e ndërmarrjeve private. Megjithatë në kontekstin shqiptar me qëllim edhe ruajtjen e ekuilibrave buxhetorë një ndarje e ndryshme lehtësisht në favor të pushtetit qendror sjell një kontribut më cilësor nga të dy llojet e pushteteve tek qytetari.

Ndryshimi i raportit të shpërndarjes së të ardhurave nga renta nga 5 në 25% në për kategorisë paguese të rentës, do të ulte sasinë e të ardhurave që shkojnë në buxhetin e shtetit, por do të kishte një ndikim minimal në qëndrueshmërinë e financave publike. Në anën tjetër, rritja e të ardhurave të drejtpërdrejta ka ndikim të konsiderueshëm në autonominë financiare të NJQV-ve dhe këto të ardhura do të rrisin burimet financuese për pasojat e drejtpërdrejta dhe të tërthorta të veprimtarive të ndërmarrjeve nxjerrëse. Kjo do të sjellë gjithashtu një përmirësim të autonomisë fiskale dhe financiare të NJQV-ve, si një element i rëndësishëm për decentralizimin në funksion të forcimit të demokracisë. Rishikimi i raporteve të shpërndarjes së të ardhurave nga burimet natyrore midis qeverisë qendrore dhe NJQV-ve është proces dinamik, i cili sjell rritjen e pjesës që u takon drejtpërdrejtë NJQV-ve duke i kthyer këto të ardhura në investime për komunitetet. Një ndarje e drejtë dhe më efikase e të ardhurave midis qeverisë qendrore dhe NJQV-ve do t'i ofronte këtyre të fundit burime më të drejtpërdrejta, jo vetëm për të kompensuar pasojat direkte dhe indirekte që sjellin ndërmarrjet nxjerrëse dhe përpunuese për banorët dhe fermerët në këto zona, por edhe për të siguruar investime të dedikuara për përmirësimin e mjedisit të përgjithshëm social dhe ekonomik në këto NJQV.

Pikënisja e kësaj nisme ligjore për rritjen e burimeve potenciale të drejtpërdrejta për NJQV-të është gjithashtu përmirësimi, lehtësimi dhe ulja

e vonesave të krijuara nga sistemi aktual administrativ për mbledhjen dhe transferimin e të ardhurave nga renta e cila duhet të rregullohet me Udhëzim të Ministrit të Financave. Subjektet që shesin produkte minerare brenda vendit bëjnë deklarimin e taksës së rentës në një platformë elektronike të DPT-së. Drejtoritë rajonale të tatimeve dhe degët e doganave, duke qenë agjentë tatimorë, disponojnë informacion analitik për vlerën e rentës minerare të mbledhur, subjektin tatimor, dhe njësinë e qeverisjes vendore ku kryhet aktiviteti. Në këtë kontekst, nëse pagesa e rentës siç propozohet në projektligj, do të kryhej drejtpërdrejt në llogaritë NJQV-ve nga agjentët tatimorë, procesi do të shkurtohej ndjeshëm. Kjo do të sillte një shpërndarje të plotë të pagesës së rentës në masën 100% pa asnjë humbje.

Ndarja e të ardhurave nga renta minerare midis pushtetit vendore dhe qendror përbën një politikë normale fiskale të decentralizimit fiskal. Mirëpo, për këtë ndarje të ardhurash midis dy pushteteve, praktika ka treguar që, "de facto", shumë pak rentë të marrë pushteti vendor. Projektligji synon në këtë mënyrë pikërisht të zgjidhë përfundimisht çështjen e "ndarjes së taksës së rentës minerare" midis pushtetit vendor dhe pushtetit qendror dhe lehtësimin e shpërndarjes së saj tek NJQV-të.

### **XIII. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUESHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR**

Projektligji është mbështetur në nenet 78, 83, pika 1, dhe 155 të Kushtetutës.

### **XIV. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTARE**

Ky projektligj nuk synon përafrimin e legjislacionit me Acquis Communautaire.

### **XV. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTLIGJIT**

Nga pikëpamja teknike, projektligji është hartuar në 2 nene.

- Në nenin 1, të projektligjit, propozohet që përqindja e të ardhurave nga renta minerare që i takojnë pushtetit vendor ku zhvillohet veprimtaria të jetë 25 për qind e të ardhurave nga renta minerare nga aktivitetet e lejuara sipas legjislacionit në fuqi për minierat, Ndërsa përqindja e të ardhurave nga renta minerare për produktet e naftës dhe gazit mbetet e pandryshuar në nivelin 25%. Të ardhurat nga renta minerare të përdoren për investime nga njësitë e qeverisjes vendore. Gjithashtu me synim thjeshtimin e shpërndarjes së të ardhurave nga renta minerare tek NJQV-të projektligji parashikon që të ardhurat nga renta minerare



të shpërndahen nga degët e doganave në rrethe drejtpërdrejtë në llogaritë e njësive të qeverisjes vendore ku zhvillohet veprimtaria. Kjo do të sillte përmirësimin, lehtësimin dhe uljen e vonesave të krijuara nga sistemi aktual administrativ për mbledhjen dhe transferimin e të ardhurave nga renta.

- Në nenin 2 të projektligjit, parashikohet hyrja në fuqi e tij.

## **XVI. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN ME ZBATIMIN E AKTIT**

Për zbatimin e këtij projektligji ngarkohen Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

## **XVII. MINISTRITË INSTITUCIONET DHE PERSONAT QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKT-AKTIT**

Projektligji është hartuar nga grupi i punës së ngritur nga prezenca e OSBE në Shqipëri me ekspertët e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe i konsultuar me përfaqësitë e njësive të vetëqeverisjes vendore.

## **XVIII. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE**

Projektligji parashikon efekte financiare në buxhetin e shtetit nga propozimi për ndryshimin e raportit të shpërndarjes si dhe ka një ndikim minimal në qëndrueshmërinë e financave publike sepse bëhet fjalë vetëm për rritjen e thelbësore të përqindjes së rentës nga industria minerare ndërkohë që për rentën minerare të paguar nga subjektet që ushtrojnë veprimtarinë në sektorin e hidrokarbureve përqindja e rritjes është më e vogël. Në anën tjetër, ndikimi i rritjes së të ardhurave nga renta minerare për NJQV-të, ka një ndikim të ndjeshëm në të ardhurat e drejtpërdrejta të NJQV-ve dhe këto të ardhura mund të shtojnë financimet për kostot e drejtpërdrejta dhe ato të tërthorta që krijojnë industrinë nxjerrëse në komunitetet ku ato veprojnë.

Analiza e produktit të brendshëm bruto/PBB dhe të ardhurat totale të buxhetit për periudhën 2015-2022 tregon se të ardhurat totale nga renta i përqindje e PBB-së, të ardhurat totale nga renta janë vetëm 0.25% ndërsa të ardhurat totale të buxhetit të shtetit janë 0.89 përqind. Bazuar në këta tregues, pesha shumë e vogël e të ardhurave nga renta në burimet totale të buxhetit të shtetit krijon hapësira për studimin e opsioneve për të rritur gradualisht pjesën e NJQV-ve nga 5 për qind që është tashmë në një pjesë përqindjeje më të drejtë dhe më mbështetëse të paktën në sektorin minerar që është ai që sjell dhe dëmtohet më të mëdha, e cila mund të sjellë përfitime reale për komunitetin në këto fusha pa cenuar stabilitetin e financave publike dhe

rregullat e menaxhimit të financave publike.

Më konkretisht, propozimi për ndryshimin e masës përfituese që i kalon pushtetit vendor nga 5% që është aktualisht në 25%, ka këto ndikime financiare në buxhet bazuar mbi të dhënat buxhetore të viteve 2018-2020. Rezulton se për vitin 2020, pushteti vendor mundë të përfitonte rentë minerare në vlerën 561 milionë lekë, pra 449 milionë lekë më shumë sesa ka përfituar realisht gjatë këtij viti.

Për vitin 2019, pushtetit vendor mund ti takonte vlera 909 milion lekë ose ndryshe rreth 727 milion lekë më shumë se sa ka përfituar. Ndërsa për vitin 2018, ky parashikim përcakton si masë takuese vlerën rreth 934 milion lekë ose ndryshe rreth 747 milion lekë më shumë se masa që ka përfituar.

Raportet e vlerës së rentës minerare që i kalon pushtetit vendor (parashikimi 25%), krahasuar me të ardhurat e pushtetit qendror, transfertën e pakushtëzuar, apo shpenzimet e pushtetit vendor paraqiten si më poshtë:

- Të ardhurat nga renta minerare akorduara nga pushteti qendror njësisive të vetëqeverisjes vendore (parashikimi 25%), në raport me shpenzimet e pushtetit vendor për vitin 2020, parashikohet të zërë rreth 0.14%, për vitin 2019 pesha do të ishte rreth 0.21%, ndërsa për vitin 2018 rreth 0.22%. Për të tre vitet përqindja do të ishte më e lartë se ajo që është aktualisht;
- Të ardhurat nga renta minerare akorduara nga pushteti qendror njësisive të vetëqeverisjes vendore (parashikimi 25%), në raport me transfertën e pakushtëzuar që i transferohet pushtetit vendor nga ai qendror për vitin 2020, zënë rreth 2%, për vitin 2019 zënë rreth 4%, si dhe për vitin 2018 zënë po rreth 4%;
- Të ardhurat nga renta minerare akorduara nga pushteti qendror njësisive të vetëqeverisjes vendore (parashikimi 25%), në raport me shpenzimet e pushtetit vendor për vitin 2020 zënë rreth 1.1%, për vitin 2019 rreth 1.6%, si dhe për vitin 2018 rreth 1.9%.

Siç shihet, ndikimi i uljes së të ardhurave nga renta minerare për buxhetin e shtetit është shumë i ulët, ndërsa rritja e pjesës për pushtetin vendor zë një peshë të konsiderueshme për buxhetin vendor.

**KËSHILLI I MINISTRAVE**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KUVENDI**

**PROJEKTLIGJ**

**Nr. \_\_\_\_ / 2021**

**PËR  
NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR. 9975, DATË 28.7.2008, “PËR TAKSAT  
KOMBËTARE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e një deputeti,

**KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**V E N D O S I:**

Në ligjin nr. 9975, datë 28.7.2008, “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar, bëhet ky ndryshime:

**Neni 1**

Në nenin 4, bëhet ndryshimi si më poshtë:

1. Në pikën 4, fjalia e fundit e paragrafit të dytë, ndryshohet si më poshtë:

“25 për qind e të ardhurave nga renta minerare nga aktivitetet e lejuara sipas legjislacionit në fuqi për minierat, dhe 25 për qind e të ardhurave nga renta minerare për produktet e naftës dhe gazit i takojnë pushtetit vendor ku zhvillohet veprimtaria. Të ardhurat nga renta minerare përdoren për investime nga njësitë e qeverisjes vendore. Të ardhurat nga renta minerare shpërndahen nga Ministria përgjegjëse për Financat në llogaritë e njësive të qeverisjes vendore ku zhvillohet veprimtaria”.

**Neni 2**

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E EKONOMISË DHE FINANCEVE  
MINISTRI**

**UDHËZIM**

**Nr. \_\_, datë \_\_.\_\_.2021**

**PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 26, DATË 4.9.2008, "PËR  
TAKSAT KOMBËTARE", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të ligjit nr. 9975, datë 28.7.2008, "Për taksat kombëtare", të ndryshuar, ministri i Financave

**UDHËZON:**

Në udhëzimin nr. 26, datë 4.9.2008, "Për taksat kombëtare", të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. *Pika 2.5.4 ndryshon si më poshtë:*

"Drejtoritë rajonale tatimore dhe degët doganore të cilat janë agjentë tatimorë, brenda datës 30 të çdo muaji dërgojnë informacion analitik pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit në Ministrinë e Financave dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit, për vlerën e rentës minerare të mbledhur, subjektin tatimor dhe njësitë e qeverisjes vendore ku kryhet aktiviteti, sipas formularit nr.9 bashkëlidhur këtij udhëzimi si pjesë përbërëse e tij."

2. *Pika 2.5.6 ndryshon si më poshtë:*

"Pjesa e të ardhurave nga renta minerare, sipas përqindjes së përcaktuar në Ligj, që u takon njësive të qeverisjes vendore ([përfshirë edhe ato të naftës dhe gazit sipas pikës 2.5.5](#)), shpërndahet nga strukturat përgjegjëse të buxhetit në Ministrinë e Financave. Ministria e Financave brenda 15 ditësh nga marrja e informacionit nga Drejtoritë rajonale tatimore dhe degët doganore, njofton zyrtarisht drejtorinë rajonale të tatimeve/doganave, respektive, dhe njësinë e qeverisjes vendore, për masën e llogaritur të shpërndarjes së të ardhurave nga renta minerale, si dhe autorizon Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit të derdhë brenda 5 ditësh në llogaritë bankare të njësive të qeverisjes vendore

ku kryhet aktiviteti, pjesën takuese të të ardhurave nga renta minerare.”.

3. *Paragrafi i parë i Shtojcës nr. 1 “Shpërndarja e rentës minerare tek njësitë vetëqeverisjes vendore për produktet e naftës dhe gazit” ndryshohet si më poshtë:*

Administrata qendrore tatimore dhe administrata doganore, për rentën minerare të paguar nga subjektet e mëposhtme, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në sektorin e hidrokarbureve, nga totali i rentës së paguar, 25% e të ardhurave mujore nga kjo rentë, ndahet në % sipas komunave dhe bashkive të specifikuara si më poshtë.

4. *Kudo në pikat 1 deri në 8 të Shtojcës nr. 1 “Shpërndarja e rentës minerare me pushtetin vendor për produktet e naftës dhe gazit”, përqindja totale e rentës minerare për prodhimin e naftës e gazit, që i shpërndahet bashkive dhe njësisve administrative përkatëse, zëvendësohet me përqindjen e përcaktuar në pikën 3 të këtij Udhëzimi.*

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin e tij në Fletoren Zyrtare.

**MINISTRI I FINANCAVE**



SHOQATA  
PER AUTONOMI  
VENDORE



SHOQATA E  
BASHKIVE TË  
SHQIPËRISË